# Fluori
# Flúor



Kujdesi për dhëmbët tek fëmijët

Tannvernd barna



Konsiderohet që një përqindje fluori e pakët por e vazhdueshme në gojë është e nevojshme për mirëmbajtjen e dhëmbëve të shëndetshëm. Fluori është pjesë e proçesit të forcimit dhe rregullimit të dhëmbëve që ndodh vazhdimisht në sipërfaqe të tyre, për më tepër, ka influencë në ndalimin e punës së bakterieve, që shkaktojne gërryerjet. Puna e fluorit është e lidhur me sipërfaqen e dhëmbëve dhe problemet e shkaktuara nga ato, në të gjitha grupmoshat.

Larja e dhëmbëve me pastë dhëmbësh me përqindje fluori 0.1%, dy herë në ditë, siguron marrjen e kësaj sasie të caktuar fluori në gojë dhe ka një influencë të madhe në mbrojtjen e përditshme ndaj prishjes së dhëmbëve. Kini parasysh rastet kur, fëmijët nën gjashtë vjeç gëlltitin pastë dhëmbësh, prandaj është e rëndësishme që fëmijët mos e racionojnë (vendosin) vetë pastën mbi furçë dhe sigurisht duhet ruajtur pasta në një vend ku fëmijët të mos e arrijnë.

Megjithëse nuk merret më në konsideratë në përgjithësi përdorimi i tabletës së fluorit nga fëmijët për mbrojtjen nga dëmtimi i dhëmbëve, një grup i caktuar fëmijësh duhet të marrin shtesë fluori, sepse nuk iu mjafton sasia e fluorit e marrë nga larja e zakonshme dy herë në ditë. Dentisti udhëzon përdorimin shtesë të fluorit dhe është e rëndësishme të ndiqen dhe zbatohen me kujdes udhëzimet.

Fëmijëve nga mosha gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjeç, periudhë gjatë së cilës dalin dhëmbët e përhershëm, u duhet shtesë fluori, p. sh në formën e llakut dhe shpëlarjeve me fluor, për më tepër kur për shkak të zakoneve jo të mira të ngrënies, rritet nevoja e përdorimit të tij.







Sasia e duhur e pastës së dhëmbëve me fluor

## Fluor për të gjithë

Talið er að lágur en stöðugur flúorstyrkur í munnholi sé nauðsynlegur til viðhalds heilbrigði tanna. Flúor tekur þátt í því viðgerðarferli sem stöðugt er í gangi við yfirborð tannanna auk þess að hafa truflandi áhrif á starfsemi þeirra baktería sem valda tannskemmdum. Verkun hans er staðbundin á yfirborði tanna og varnandi áhrif þau sömu hjá öllum aldurshópum.

Tannburstun með flúortannkremi að styrkleika 0,1% F- tvisvar sinnum á dag viðheldur lágmarksflúorstyrk í munnholi og er því afar áhrifamikill þáttur í daglegri vörn gegn tannskemmdum. Hafa ber í huga að þar sem börn undir sex ára aldri kyngja stórum hluta tannkremsins sem upp í þau fer er mikilvægt að þau skammti sér það ekki sjálf og öruggast að geyma tannkremið þar sem þau ná ekki í það.

Þótt ekki sé lengur mælt með almennri notkun flúortaflna til varnar tannskemmdum hjá börnum þarfnast ákveðinn hópur barna sem hætt er við tannskemmdum meiri flúorverndar en flúortannburstun tvisvar á dag veitir. Tannlæknir leiðbeinir um viðbótarnotkun flúors og mikilvægt er að fylgja fyrirmælum um rétta notkun.

Börn á aldrinum sex til fimmtán ára sem eru að fá upp nýjar fullorðinstennur þarfnast aukinnar flúorverndar í formi flúorlökkunar og skolunar auk þess sem slæmar neysluvenjur kalla á aukna flúorvernd.







Hæfilegt magn flúortannkrems

## Flúortannkrem (0.1% F- ) fyrir alla káta krakka!

ALBANSKA